



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Driton Fetaj	20.02.2026	03.03.2026	2026/0096

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.02.2026, OE "" AUTOTRADE " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0096, kundër njoftimit B58 mbi vendimin për dhenje të kontratës ku është rekomanduar për kontratë AUTOBUQA SH.P.K , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-se" me nr. të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës: furnizim vlera e parashikuar e kontratës: 500.000,00 €.

Nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. nr: 2026/0096, dt:13.02.2026.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: POLICIA E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	214/30400-25-10109-1-1-1
Nr i brendshëm	214/25/131/111

Sa i përket tenderit për: "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AUTOTRADE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.MAGJISTRALJA PRISHTINE FERIZAJ

(Adresa)

Llapanaselle

10 052

(Vendi)

(Kodi postar)

038-600-260

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ylli Hajdari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

INFO@AUTOTRADE-KS.COM

(Adresa elektronike)

13.02.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 04.11.2025

Data e hapjes së ofertave dt. 17.12.2025

Njoftimi mbi vendimin i dt. 23.01.2026

Kërkesa për rishqyrtim e dt.28.01.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 04.02.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Faqe 2 nga 11

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtuani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 04.11.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 17.12.2025, ku kanë ofertuar 2 kompani.

Me dt.23.01.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE "AUTOBUQA" SH.P.K., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si nw vijim:

OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

1.Sipas nenit 4.1 pikës C të rregullores nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut dhe çmimet e parashkuar nga AK për artikullin:

Pjesa A Pozicionet:1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 15,19, 20.

Pjesa B Pozicionet: 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 33, 38, 39, 41, 42, 45, 46, 47, 48, 50, 53, 54, 68, 73, 75, 77, 78, 81, 85, 86, 89, 90, 91, 92, 100, 101, 104, 105, 106, 107, 109, 115, 116, 117, 118, 119, 123.

Pjesa C Pozicionet:128, 129, 130, 133, 134, 138, 141, 142, 145, 146, 148, 149, 150, 151, 157, 159, 160.

Komisioni I vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE se si ka arritur te këto çmime për artikujt e larte përmendur .

Komisioni ka pranuar përgjigje ne lidhje me sqarimet e kërkuar , për komisionin e vlerësimit sqarimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse .Andaj oferta juaj është e pa përgjegjshme

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm për faktin se ne i kemi dhënë sqarimet e kërkuara autoritetit kontraktues, ku e kemi vërtetuar se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne janë çmime të tregut.

Në përgjigjen tonë e kemi sqaruar se: *"Për të ju deshmuar se POLICIA E KOSOVËS, është klient ekskluziv dhe se gjithmonë merr zbritjet më të mira në treg, për të gjitha pikat e kërkuara, ju kemi bashkangjitur çmimet të cilat janë në sistemet e TOYOTA, si dhe çmimet të cilat ju janë ofruar me zbritje për POLICINE E KOSOVËS. Në rast se dëshironi çmime krahasuese, dhe hulumtimi të jetë sa më i sakte dhe më i drejtë, ju preferojmë të dërgoni kërkesë tek përfaqësuesi i Toyota për pjesë origjinale kudo në rajon apo në botë për pjesët dhe do të vërtetoheni që çmimet e ofruara janë më të lira/ulëta".* Njëkohësisht AK-së i kemi ofruar edhe dëshmitë përkatëse në lidhje me çmimet tona, mirëpo që të njëjtat nuk janë marr parasysh fare, me qëllimin e vetëm që ne të shpallemi si tenderues i eliminuar, ashtu siç edhe ka vepruar AK-ja tek njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Ne nuk e kemi të qartë se si ka ardh në përfundim AK-ja se çmimet tona janë më të larta se çmimet e tregut, përderisa çmimet janë dhënë nga prodhuesi ndërsa ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashkuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse në rast se ka pasur ende dilema ka mundur të kërkoj sqarime shtesë edhe nga ana e prodhuesit tonë.

Po ashtu duhet cekur fakti se çmime në treg mund të ketë eventualisht më të lira se sa oferta jonë por ato çmime mund të jenë për pjesë jo origjinale, ndërsa për pjesët origjinale të Toyota nuk ka asnjë mundësi të ketë çmime më të lira se sa oferta jonë.

Pa një analizë të çmimeve të tregut nuk mund të eliminohe mi nga konkurrenca dhe atë pa një analizë të mirëfilltë, sepse analiza e çmimeve të tregut nuk mund të jetë krahasuese nëse **analizohen çmimet e pjesëve jo origjinale me çmimin e pjesëve origjinale.**

Gjithashtu sqarojmë se ne kemi kërkuar qasje në dokumente, ku autoritetit kontraktues na ka lejuar qasjen në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë.

Pas analizës që i kemi bërë dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë kemi ardh në përfundim që i njëjti është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar *"c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezerve (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës)",* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezerve (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj".*

OE i rekomanduar për kontratë për pozicionet nr.176, ka prezantuar autorizimin dhe ka deklaruar prodhuesin SRL RICAMBI - ITALI.

Shih pozicionin:

176	Kompjuter(moduli) airbagave	copë	1	360.00	360.00	SRL RICAMBI - ITALI
-----	-----------------------------	------	---	--------	--------	---------------------

Sa për sqarim Pozicioni 176 përfshin pjesë kritike të sistemit elektronik të automjetit, i cili është pjesë me softuer të mbrojtur me të drejta pronësie nga Toyota dhe nuk mund të prodhohet apo të kopjohet ligjërisht nga asnjë prodhues tjetër në botë pa licencë.

Nuk ka prodhues tjerë që mund t'i prodhojnë ligjërisht këto pjesë pa licencim nga Toyota, pasi të njëjtat produkte përmbajnë softuer të pronësisë industriale të Toyota-s dhe këto pajisje përfshihen në sistemin e menaxhimit të sigurisë (ECU Immobilizer/Engine Management).

Duhet cekur fakti se në lidhje me pozicionin e lartcekur, çdo ndërhyrje jo-origjinale ose pjesë e paautorizuar që vendoset në veturë, rrezikon mosaktivizimin e airbagëve, shkakton gabime kritike (fault codes) në sistem dhe komprometon sigurinë e pasagjerëve.

Prodhues të tjerë jo të licencuar (SRL RICAMBI - ITALI apo edhe kompanitë tjera) mund të kopjojnë apo falsifikojnë pjesë mekanike të zakonshme, si p.sh: gjysëm boshti (zglobi), manzeta të nyjeve të zglobit, sajlla të frenit të dorës, cilindër kryesor i frenave, pirun i epërm, karter i hekurit, nxehtës motorit, brushat e starterit (anllaserit), rryp i alternatorit, etj., por, këto janë pjesë me funksion mekanik ose konsumues, të cilat mund të prodhohen nga kompani të ndryshme si alternativa tregtare. E njëjta gjë nuk vlen edhe për pajisjen e lartcekur përkatësisht për kompjuterin e airbagave, i cili prodhohet ekskluzivisht nga Toyota dhe partnerët e saj të licencuar.

Prandaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar autorizim nga prodhuesi i lartcekur, i cili në asnjë mënyrë nuk mund të prodhojë, kopjoj apo edhe falsifikoj produktet e kërkuara tek pozicioni nr.176.

Kur kemi parasysh këto fakte kuptohet qartë se pranimi i autorizimeve nga subjekte të tjera që nuk janë të autorizuar nga prodhuesi origjinal Toyota për prodhimin apo tregtimin e këtij pozicioni përbën shkelje të rregullave të prokurimit dhe krijon avantazh të padrejtë konkurrues. Duke qenë se pozicioni i lartcekur është pjesë e sistemit të menaxhimit të sigurisë së automjetit dhe përmban softuer të mbrojtur me të drejta pronësie industriale, asnjë kompani tjetër, përveç subjekteve të licencuara nga Toyota, nuk mund ta prodhojë apo ta tregtojë ligjërisht këtë produkt, mirëpo AK-ja me qëllim që të favorizoj OE të rekomanduar për kontratë po i pranon autorizimet edhe nga prodhues të cilët nuk mund të prodhojnë pozicionin e lartcekur.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku është kërkuar “b) OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km)”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre”.

I njëjti OE ka prezantuar marrëveshjen të lidhur me kompaninë Autoservis DILI, mirëpo kur analizohet marrëveshja, shihet qartë se e njëjta është marrëveshje për servisim dhe jo për marrje me qira të objektit, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Pra tek dëshmia dokumentare është specifikuar decidivisht “Nëse OE objektin e servisit e ka me

marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre".

Tek titulli i marrëveshjes shënohet qartë marrëveshje për servisimin e automjeteve për këtë projekt, por jo marrëveshje për marrjen me qira të objektit/servisit.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur me datë 17.12.2025 në mes të kontraktuesve:

- 1 Kompania "AUTOBUQA" SH.P.K me pronar Liridon Buqaj me seli ne Prizren Rr. Ismail Kryeziu, nr. 498, Prizren me nr. Unik: 812283430 dhe
- 2 Kompania "HILI" SH.P.K me pronar Fitim Sylejmani me nr Unik: 811434662 me seli ne Rr. Rruga e Pejes, nr. 554 Fushë Kosovë,

Neni I

Lidhin këtë marrëveshje për servisimin e automjeteve per projektin per Policin e Kosovës :

FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së

Numri i prokurimit: 214/30400/25/10109/1/1/1/

Servisimi i Automjeteve do te kryhet nga AUTO SERVIS "HILI"SH.P.K

Në këtë rast kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar marrëveshje për marrjen me qira të objektit, mirëpo është lidhur marrëveshje për servisim e cila është në kundërshtim të plotë me kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit.

Prandaj kur kemi parasysh këtë fakt kuptohet qartë se i njëjti grup i OE të rekomanduar për kontratë, janë të papërgjegjshëm sepse nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit.

Gjithashtu marrëveshja është në kundërshtim të plotë me kërkesën e dosjes së tenderit dhe legjislacionin në fuqi, pasi që në marrëveshje specifikohet që Kompania AUTOBUQA SHPK dhe HILI SHPK, do të kryejnë servisimet, kodimet/dekodimet, diagnostifikimet dhe rigjenerimet, që nënkuptohet se OE i rekomanduar për kontratë me këtë marrëveshje e deklaron si nënkontraktor kompaninë HILI SHPK.

Kur analizohet formulari i tenderit i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë askund nuk figuron kompania HILI SHPK, si nënkontraktor. Shih formularin e mëposhtëm:

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

Në këtë rast kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë duhej të konsiderohej edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë, duke e treguar qartë favorizimin që po i bëhet të njëjtit OE.

Njëkohësisht tek dosja e tenderit specifikohet sakte: *Nënkontraktimet-12.1-a) një deklaratë ku deklarohen nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b) Të gjithë nënkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.*

Dokumenti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim të plotë edhe me kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku specifikohet "d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej shërbimet pa kosto shtesë - E diagnostifikimit të prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik.", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej këto shërbime pa kosto shtesë - Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik".

Pra në kërkesë specifikohet se "Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik", dhe jo nga ndonjë palë e tretë, por nga operatori ekonomik, prandaj i njëjti duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit, sepse nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar "a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës së njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njashtimit për kontrate) ne vlere minimum 500,000.00€".

Nga dokumentet që i njëjti ka prezantuar në ofertë përkatësisht kur analizohet certifikata e biznesit emri në të figuron AUTOBUQA SH.P.K., ndërsa numri i biznesit 812283430, ndërsa data e regjistrimit të biznesit shënon 22.05.2025.

Kur analizohet kontrata e lidhur me KRU. HIDROREGJIONI JUGOR SHA PRIZREN, shihet se data e nënshkrimit të kontratës është 18.02.2020, ndërsa përfundimi i saj është me dt.14.01.2023, që nënkuptohet se kjo kontratë nuk është kryer nga kjo kompani, pasi që siç e cekëm data e themelimit sipas dokumenteve të biznesit është 22.05.2025.

Të gjitha referencat tjera të cilat janë lëshuar në emër të Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", nuk mund dhe nuk është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që të njëjtat janë të lëshuara për një kompani tjetër dhe jo pikërisht për këtë kompani që është rekomanduar për kontratë. Pasi që siç edhe e cekëm më lartë OE i rekomanduar për kontratë është regjistruar në ARBK me dt.22.05.2025. Njëkohësisht duhet cekur fakti se pronar tek Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" figuron që ka qenë Xhemajl Buqa, ndërsa tani tek AUTOBUQA SH.P.K., janë dy pronar Xhemajl Buqa dhe Liridon Buqaj, andaj në këtë rast kuptohet qartë se AUTOBUQA SH.P.K., është biznes i ri dhe nuk ka lidhje me kompaninë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", pasi janë kompani të ndryshme.

Njëkohësisht në dyshojmë që autorizimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, janë të falsifikuara, pasi që veç nëse analizohen në mënyrë sipërfaqësore, shihet qartë se fonti i shkronjave pothuajse në asnjërin nga autorizimet nuk është i njëjtë. Gjithashtu nga të gjitha autorizimet, diku shënohet tekst në gjuhën shqipe e diku në gjuhën angleze, pra këto janë dyshime se si ka mundësi një autorizim i vetëm të jetë gjysma në gjuhën shqipe, e gjysma tjetër në gjuhën angleze. Prandaj kërkohet që të komunikohet direkt me kompanitë të cilat i kanë lëshuar autorizimet dhe të konfirmohet se a janë lëshuar në këtë mënyrë këto autorizime për OE të rekomanduar për kontratë.

Duhet cekur fakti se edhe kompania HILI SHPK, për të cilën autoriteti kontraktues dhe OE i rekomanduar për kontratë e kanë cekur se do të kryej servisimin, sqarojmë se i njëjti nuk ka përvojë në servisimin e këtyre automjeteve siç janë automjetet për të cilat do të bëhet servisimi. Nga dokumentet që janë prezantuar në ofertë shihet qartë se ky servis deri me

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AUTOTRADE " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së" me numër të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS



Dokumenti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim të plotë edhe me kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku specifikohet “d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej shërbimet pa kosto shtesë - E diagnostifikimit të prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik.”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej këto shërbime pa kosto shtesë - Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik”.

Pra në kërkesë specifikohet se “Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik”, dhe jo nga ndonjë palë e tretë, por nga operatori ekonomik, prandaj i njëjti duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit, sepse nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar “a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës së njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) në vlerë minimum 500,000.00€”.

Nga dokumentet që i njëjti ka prezantuar në ofertë përkatësisht kur analizohet certifikata e biznesit emri në të figuron AUTOBUQA SH.P.K., ndërsa numri i biznesit 812283430, ndërsa data e regjistrimit të biznesit shënon 22.05.2025.

Kur analizohet kontrata e lidhur me KRU. HIDROREGJIONI JUGOR SH.A PRIZREN, shihet se data e nënshkrimit të kontratës është 18.02.2020, ndërsa përfundimi i saj është me dt.14.01.2023, që nënkuptohet se kjo kontratë nuk është kryer nga kjo kompani, pasi që siç e cekëm data e themelimit sipas dokumenteve të biznesit është 22.05.2025.

Të gjitha referencat tjera të cilat janë lëshuar në emër të Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë “Buqa”, nuk mund dhe nuk është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që të njëjtat janë të lëshuara për një kompani tjetër dhe jo pikërisht për këtë kompani që është rekomanduar për kontratë. Pasi që siç edhe e cekëm më lartë OE i rekomanduar për kontratë është regjistruar në ARBK me dt.22.05.2025. Njëkohësisht duhet cekur fakti se pronar tek Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë “Buqa” figuron që ka qenë Xhemajl Buqa, ndërsa tani tek AUTOBUQA SH.P.K., janë dy pronar Xhemajl Buqa dhe Liridon Buqaj, andaj në këtë rast kuptohet qartë se AUTOBUQA SH.P.K., është biznes i ri dhe nuk ka lidhje me kompaninë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë “Buqa”, pasi janë kompani të ndryshme.

Njëkohësisht në dyshojmë që autorizimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, janë të falsifikuara, pasi që veç nëse analizohen në mënyrë sipërfaqësore, shihet qartë se fonti i shkronjave pothuajse në asnjërin nga autorizimet nuk është i njëjtë. Gjithashtu nga të gjitha autorizimet, diku shënohet tekst në gjuhën shqipe e diku në gjuhën angleze, pra këto janë dyshime se si ka mundësi një autorizim i vetëm të jetë gjysma në gjuhën shqipe, e gjysma tjetër në gjuhën angleze. Prandaj kërkohet që të komunikohet direkt me kompanitë të cilat i kanë lëshuar autorizimet dhe të konfirmohet se a janë lëshuar në këtë mënyrë këto autorizime për OE të rekomanduar për kontratë.

Duhet cekur fakti se edhe kompania HILI SHPK, për të cilën autoriteti kontraktues dhe OE i rekomanduar për kontratë e kanë cekur se do të kryej servisimin, sqarojmë se i njëjti nuk ka përvojë në servisimin e këtyre automjeteve siç janë automjetet për të cilat do të bëhet servisimi. Nga dokumentet që janë prezantuar në ofertë shihet qartë se ky servis deri me

dt.09.10.2024 nuk ka pasur as servis të tijin, ku me këtë datë ka lidh marrëveshjen për marrjen me qira të objektit. Këtu shihet qartë se i njëjti nuk e posedon edhe përvojën për të kryer punët e servisimit të automjeteve të cilat janë mjaft komplekse dhe për të njëjtat kërkohet përvojë e madhe në fushën e servisimit, dekodimit, montimit, etj.

Duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së. Prandaj kërkohet nga ana e AK-së që të analizohen në tërësi të gjitha pretendimet tona ankimore dhe dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe pastaj të nxjerret një vendim meritior.

Ne me dt.04.02.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e tij është arsyetuar si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë për pozicionet nr.176, ka prezantuar autorizimin dhe ka deklaruar prodhuesin SRL RICAMBI - ITALI.

Shih pozicionin:

176	Kompjuter(modul) airbagave	copë	1	360.00	360.00	SRL RICAMBI - ITALI
-----	----------------------------	------	---	--------	--------	---------------------

AK sqaron se kjo pike nuk qëndron sepse autorizimi i prodhuesit të pjesëve rezerve i ofruar nga OE e obligon prodhuesin që këta artikujt të ofrohen sipas FDT dhe specifikave teknike të detyrueshme tek Aneksi I. Edhe në komunikimet të cilat i kemi bërë me këtë prodhues ky prodhues është zotuar dhe ka aprovuar se do t'i përmbush të gjitha obligimet të cilat i përkasin lidhur autorizimin e lëshuar për këta artikuj të cilët i prodhon.

Pas kërkesë për rishqyrtim AK ka komunikuar me prodhuesin e lartë cekuar në lidhje me pretendimet tuaj dhe prodhuesi konfirmon që është prodhues dhe ka në stok andaj ky pretendim i OE është i pa bazuar.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues se ka komunikuar me prodhuesin e pjesëve të cilat i kemi cekur më lartë dhe se i njëjti është zotuar dhe ka aprovuar se do ti përmbush obligimet që i përkasin më autorizimin e lëshuar për këta artikuj dhe i njëjti ka konfirmuar se i prodhon këta artikuj sipas kërkesës së AK-së, është arsyetim krejtësisht jo profesional. Përderisa për pjesët e specifikuar tek pozicioni 176, ne jemi njofuar nga vet prodhuesi origjinal i këtyre pjesëve Toyota i cili ka deklaruar se prodhuesit të cilat i ka deklaruar grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të autorizuar të bëjnë shitjen apo prodhimin e produkteve të TOYOTA apo pjesëve shtesë, atëherë është jo profesionale të i besohet një prodhuesi i cili nuk është i autorizuar nga prodhuesi origjinal i pjesëve, pasi që vet tenderi ka të bëjë me furnizim me pjesë për automjetet Toyota Land Crusier.

Pra autoriteti kontraktues po e merr parasysh një konfirmim të një prodhuesi i cili nuk është i autorizuar të bëjë shitjen apo prodhimin e pjesëve për automjetet të cilat i prodhon vet prodhuesi ynë pra Toyota, mirëpo nuk po e merr parasysh fare deklaratën e prodhuesit Toyota. Këtu shihet qartë se AK-ja po e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë, prandaj edhe arsyetimi i të njëjtës është i paqëndrueshëm dhe jo profesional.

Tek pretendimi tjetër i yni ku e kemi cekur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar marrëveshje për marrjen me qira të objektit/servisit, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Pika 3: ku OE grupi i OE i rekomanduar nuk kanë deklaruar si nenkontrktor kompaninë HILI SHPK
AK sqaron se kjo pik nuk qëndron sepse : AUTOBUQA SH.P.K.; „pjesët nën garancion do te servisohen ne AUTO Servisin HILI Shpk
Pretendimi qe OE e rekomanduar ka prezantuar ne marrëveshje me Auto Servis Hilli te beje diagnostifikimit të prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik nuk qëndron pasi qe mundësi ka qene qe ne qoftëse OE nuk ka servis mund te beje marrëveshje, është e qarte qe ky shërbim do te kryhet nga servisi me te cilin ka lidhur marrëveshje, andaj pretendimi nuk qëndron dhe është i pabazuar.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht është arsyetim favorizues për OE të rekomanduar për kontratë. I njëjti e ka shënuar se mundësi ka qene që në qoftë se OE nuk ka servis mund të bëj marrëveshje dhe se është e qartë se ky shërbim do të kryhet nga servisi me të cili ka lidhur marrëveshje OE. Këtu AK-ja po e pranon që servisimin do ta kryej servisi me të cilin ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi OE, ndërsa në marrëveshje specifikohet qartë:

Neni II

Kompania "AUTOBUQA"SH.P.K dhe "HILI"sh.p.k ne bashkpunim do ti kryejn servisimin (Montimin), kodimet/dekodimet, diagnostifikimet, rigjenerimet do ta kryhen ne AUTO SERVIS "HILI"SH.P.K sipas kerkeses se AK-se si dhe te gjitha pjeset qe jan nen garancion do te servisohen ne Auto Servis "Hili"sh.p.k.

Pa marr parasysh këtë fakt edhe nëse qëndron ajo që AK-ja e ka cekur se servisimin do ta kryej kompania HILI SHPK, atëherë nga ky fakt po kuptohet qartë se OE po mbështetet në kapacitetin e një subjekti tjetër për të përmbushur kërkesat teknike, përkatësisht servisimin. Në këtë rast, sipas ligjit, subjekti mbështetës apo nënkontraktori duhet të deklarohet, përdërisa vet AK-ja po e pranon që HILI SHPK do të kryejë shërbimin, pra i njëjti është nënkontraktor.

Pra në këtë rast, marrëveshja është për kryerjen e servisimit atëherë duhej të deklarohet nënkontraktimi, ndërsa në rast se OE do të bëj servisimin, atëherë është dashur të prezantohet marrëveshja për marrjen me qira të objektit. Në këtë rast asnjëra nga këto dy kushte nuk është përmbushur dhe si e tillë oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme dhe njëkohësisht edhe arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se tek dosja e tenderit specifikohet sakte: *Nënkontraktimet-12.1-a) një deklaratë ku deklarohet nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe*

b) Të gjithë nënkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.

Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, AK-ja pretendimin tonë ankimor e ka cilësuar si të pa bazuar, duke dhënë arsyetimin e njëjtë përsëri, ku e ka cekur se çmimet tona janë shumë më të larta se sa çmimet e tregut. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe tendencioz, sepse ne e kemi sqaruar qartë se çmimet tona janë dhënë nga prodhuesi dhe të njëjtat janë në harmoni me çmimet e tregut, e për më tepër ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh, pasi që ne po diskriminohe mi si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, pasi që e ka refuzuar kërkesën tonë pa ndonjë bazë ligjore.

Duhet cekur fakti se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk është distributor i autorizuar i Toyota-s dhe, rrjedhimisht, nuk ka kapacitet objektiv për të furnizuar disa nga pjesët e kërkuara që janë prodhim ekskluziv i prodhuesit dhe nuk mund të prodhohen nga dikush tjetër pa autorizim.

Ndërsa nga analiza e procedurave të njëjta të zhvilluara në tri vitet e fundit, në rastet kur operatori ekonomik i rekomanduar tani për kontratë kishte dështuar të përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit për shkak të pamundësisë për furnizim të disa pozicioneve të paramasës, në procedurat të cilat janë publikuar pastaj, autoriteti kontraktues kishte larguar pikërisht ato pozicione nga lista e pjesëve të kërkuara. Këto ndryshime nuk kanë qenë të natyrës teknike apo funksionale (p.sh. ndryshim i nevojave reale të AK-së), por të njëjtat janë bërë me qëllimin e vetëm që operatori ekonomik AUTOBUQA SH.P.K. të mund të plotësojë kriteret e dosjes së tenderit.

Nga ato që i sqaruar më lartë, kuptohet qartë se vendimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, e për më tepër ky vendim është tendencioz pasi që po favorizohet OE o rekomanduar për kontratë edhe përkundër faktit që i njëjti është i papërgjegjshëm. Njëkohësisht po diskriminohemi ne si kompani e përgjegjshme dhe e specializuar për furnizim dhe servisim të pjesëve të kërkuara, e ku jemi kompani e autorizuar nga vet prodhuesi i këtyre pjesëve.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashih qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE AUTOTRADE SH.P.K.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshtuaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjiti Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AUTOTRADE " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së" me numër të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

KRITERET PËR VLERËSIM

--

		<p>Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] <p>Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.</p>								
		<table border="1"> <tr> <td data-bbox="602 827 899 1155"> <p>Kërkesat e përshtatshmerisë:</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmerinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092</p> </td> <td data-bbox="899 827 1252 1155"> <p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2</p> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="602 1155 899 1394"> <p>b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p> </td> <td data-bbox="899 1155 1252 1394"> <p>b)Vërtetim nga Administrata Tatimore</p> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="602 1394 899 1738"> <p>c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerise" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p> </td> <td data-bbox="899 1394 1252 1738"> <p>c)Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar</p> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="602 1738 899 1797"> <p>d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se</p> </td> <td data-bbox="899 1738 1252 1797"> <p>d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore</p> </td> </tr> </table>	<p>Kërkesat e përshtatshmerisë:</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmerinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2</p>	<p>b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p>	<p>b)Vërtetim nga Administrata Tatimore</p>	<p>c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerise" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p>	<p>c)Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar</p>	<p>d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se</p>	<p>d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore</p>
<p>Kërkesat e përshtatshmerisë:</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmerinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2</p>									
<p>b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p>	<p>b)Vërtetim nga Administrata Tatimore</p>									
<p>c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerise" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p>	<p>c)Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar</p>									
<p>d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se</p>	<p>d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore</p>									

		<p>drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme</p> <p>Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës. Dëshimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.</p>	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p>Përshtatshmëria profesionale</p> <p>a) Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Certifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet të regjistroj përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)</p> <p>b) Certifikata e TVSH-se (për Operatorët Ekonomikë vendor)</p> <p>c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës)</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) Kopja e certifikatës të numrit unik.</p> <p>b) Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatorët Ekonomikë vendor)</p> <p>c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj.</p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 700,000.00 €</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) OE duhet të dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit ose nga vendi I themelimit</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuar me sukses kontrata të natyrës se njëjtte ose të ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit të</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë) e nënshkruar dhe vulosur nga</p>

		<p>njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 500,000.00€.</p>	<p>OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve, kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.</p>
		<p>b) OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km)</p>	<p>b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative - Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre.</p>
		<p>c) OE duhet të ofrojë Garancion të pjesëve I cili duhet të jetë minimum 12 muaj</p>	<p>c) Deklara me shkrim per garancion të pjesëve 12 muaj</p>
		<p>d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej shërbimet pa kosto shtesë - E diagnostifikimit të prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve-sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik.</p>	<p>d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej këto shërbime pa kosto shtesë - Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik</p>
<p>Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik</p>	<p>11.1</p>	<p>a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës</p> <p>b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p>	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AUTOTRADE" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së" me numër të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs	
	Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së

Nr. i prokurimit²	214/30400-25-10109-1-1-1
Nr i brendshëm	214/24/131/111

Nr.	Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	"AUTOTRADE" SH.P.K. – Prishtinë	14,793.96€
2.	AUTOBUQA SH.P.K.; Prizren	11,111.01€

Policia e Kosovës shpërblen me kontratë OE" AUTOBUQA SH.P.K.; në vlerë totale 11,111.01 €

Data: 23.01.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Artan Fejza



¹ Keti formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ³

20.01.2026, Prishtinë

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 33, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik: "AUTOTRADE" SH.P.K.

Nr. i prokurimit ⁴	214/30400-25-10109-1-1-1
Nr i brendshëm	214/24/131/111

Titulli: FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04 /L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

OE I refuzohet oferta

OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

1.Sipas nenit 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut dhe çmimet e parashikuar nga AK për artikullin:

Pjesa A Pozicionet:1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 15,19, 20.

Pjesa B Pozicionet: 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 33, 38, 39, 41, 42, 45, 46, 47, 48, 50, 53, 54, 68, 73, 75, 77, 78, 81, 85, 86, 89, 90, 91, 92, 100, 101, 104, 105, 106, 107, 109, 115, 116, 117, 118, 119, 123.

Pjesa C Pozicionet:128, 129, 130, 133, 134, 138, 141, 142, 145, 146, 148, 149, 150, 151, 157, 159, 160.

Komisioni I vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE se si ka arritur te këto çmime për artikujt e larte përmendur .

Komisioni ka pranuar përgjigje ne lidhje me sqarimet e kërkuar , për komisionin e vlerësimit sqarimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse .Andaj oferta juaj është e pa përgjegjshme

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni anekse pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidateve që janë eliminuar; tenderet e të cileve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).

⁴ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

XW

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

//

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

//

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

//

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

//

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " AUTOTRADE " SH.P.K.

Sqarim Hyrës Me datën: 13.02.2026, OE "AUTOTRADE " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0096, kundër njoftimit B58 mbi vendimin per dhenje te kontrates ku është rekomanduar për kontratë AUTOBUQA SH.P.K , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-se" me nr. të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës: furnizim vlera e parashikuar e kontratës: 500.000,00 €.

Pretendimin i OE "AUTOTRADE " SH.P.K"- Prishtinë :

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm për faktin se ne i kemi dhënë sqarimet e kërkuara autoritetit kontraktues, ku e kemi vërtetuar se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne janë çmime të tregut.

Në përgjigjen tonë e kemi sqaruar se: "Për të ju deshmuar se POLICIA E KOSOVËS, është klient ekskluziv dhe se gjithmonë merr zbritjet më te mira në treg, për të gjitha pikat e kërkuara, ju kemi bashkangjitur cmimet të cilat janë në sistemet e TOYOTA, si dhe cmimet të cilat ju janë ofruar me

zbritje për POLICINE E KOSOVËS. Në rast se dëshironi cmime krahasuese, dhe hulumtimi të jetë sa më i sakte dhe më i drejtë, ju preferojmë të dërgoni kërkesë tek përfaqësuesi i Toyota për pjesë origjinale kudo në rajon apo në botë për pjesët dhe do të vërtetoheni që cmimet e ofruara janë më të lira/ulëta". Njëkohësisht AK-së i kemi ofruar edhe dëshmitë përkatëse në lidhje me çmimet tona, mirëpo që të njëjtat nuk janë marr parasysh fare, me qëllimin e vetëm që ne të shpallemi si tenderues i eliminuar, ashtu siç edhe ka vepruar AKja tek njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Ne nuk e kemi të qartë se si ka ardh në përfundim AK-ja se çmimet tona janë më të larta se çmimet e tregut, përderisa çmimet janë dhënë nga prodhuesi ndërsa ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse në rast se ka pasur ende dilema ka mundur të kërkoj sqarime shtesë edhe nga ana e prodhuesit tonë.

Po ashtu duhet cekur fakti se çmime në treg mund të ketë eventualisht më të lira se sa oferta jonë por ato çmime mund të jenë për pjesë jo origjinale, ndërsa për pjesët origjinale të Toyota nuk ka asnjë mundësi të ketë çmime më të lira se sa oferta jonë.

Pa një analizë të çmimeve të tregut nuk mund të eliminohe mi nga konkurrenca dhe atë pa një analizë të mirëfilltë, sepse analiza e çmimeve të tregut nuk mund të jetë krahasuese nëse analizohen çmimet e pjesëve jo origjinale me çmimin e pjesëve origjinale.

Gjithashtu sqarojmë se ne kemi kërkuar qasje në dokumente, ku autoritetit kontraktues na ka lejuar qasjen në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë.

Pas analizës që i kemi bërë dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë kemi ardh në përfundim që i njëjti është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar "c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës)", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj". OE i rekomanduar për kontratë për pozicionet nr.176, ka prezantuar autorizimin dhe ka deklaruar prodhuesin SRL RICAMBI - ITALI. Shih pozicionin:

176Kompjuteri(moduli)I airbagave copë 1360 360SRL RICAMBI-ITALI

Sa për sqarim Pozicioni 176 përfshin pjesë kritike të sistemit elektronik të automjetit, i cili është pjesë me softuer të mbrojtur me të drejta pronësie nga Toyota dhe nuk mund të prodhohet apo të kopjohet ligjërisht nga asnjë prodhues tjetër në botë pa licencë.

Nuk ka prodhues tjerë që mund t'i prodhojnë ligjërisht këto pjesë pa licencim nga Toyota, pasi të njëjtat produkte përmbajnë softuer të pronësisë industriale të Toyota-s dhe këto pajisje përfshihen në sistemin e menaxhimit të sigurisë (ECU Immobilizer/Engine Management).

Duhet cekur fakti se në lidhje me pozicionin e lartcekur, çdo ndërhyrje jo-origjinale ose pjesë e paautorizuar që vendoset në veturë, rrezikon mosaktivizimin e airbagëve, shkakton gabime kritike (fault codes) në sistem dhe komprometon sigurinë e pasagjerëve.

Prodhues të tjerë jo të licencuar (SRL RICAMBI - ITALI apo edhe kompanitë tjera) mund të kopjojnë apo falsifikojnë pjesë mekanike të zakonshme, si p.sh: gjysëm boshti (zglobi), manzheta të nyjeve të zglllobit, sajlla të frenit të dorës, cilindër kryesor i frenave, pirun i epërm, karter i hekurit, nxehës motori, brushat e starterit (anllaserit), rryp i alternatorit, etj., por, këto janë pjesë me funksion mekanik ose konsumues, të cilat mund të prodhohen nga kompani të ndryshme si alternativa tregtare. E njëjta

gjë nuk vlen edhe për pajisjen e lartcekur përkatësisht për kompjuterin e airbagave, i cili prodhohet ekskluzivisht nga Toyota dhe partnerët e saj të licencuar.

Prandaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për

kontratë ka prezantuar autorizim nga prodhuesi i lartcekur, i cili në asnjë mënyrë nuk mund të prodhojë, kopjoj apo edhe falsifikoj produktet e kërkuara tek pozicioni nr.176.

Kur kemi parasysh këto fakte kuptohet qartë se pranimi i autorizimeve nga subjekte të tjera që nuk janë të autorizuar nga prodhuesi origjinal Toyota për prodhimin apo tregtimin e këtij pozicioni përbën shkelje të rregullave të prokurimit dhe krijon avantazh të padrejtë konkurrues. Duke qenë se pozicioni i lartcekur është pjesë e sistemit të menaxhimit të sigurisë së automjetit dhe përmban softuer të mbrojtur me të drejta pronësie industriale, asnjë kompani tjetër, përveç subjekteve të licencuara nga Toyota, nuk mund ta prodhojë apo ta tregtojë ligjërisht këtë produkt, mirëpo AK-ja me qëllim që të favorizoj OE të rekomanduar për kontratë po i pranon autorizimet edhe nga prodhues të cilët nuk mund të prodhojnë pozicionin e lartcekur.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku është kërkuar "b) OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km)", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre".

I njëjti OE ka prezantuar marrëveshjen të lidhur me kompaninë Autoservis DILI, mirëpo kur analizohet marrëveshja, shihet qartë se e njëjta është marrëveshje për servisim dhe jo për marrje me qira të objektit, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Pra tek dëshmia dokumentare është specifikuar decidivisht "Nëse OE objektin e servisit e ka me Faqe 6 nga 11 marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre". Tek titulli i marrëveshjes shënohet qartë marrëveshje për servisimin e automjeteve për këtë projekt, por jo marrëveshje për marrjen me qira të objektit/servisit

Në këtë rast kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar marrëveshje për marrjen me qira të objektit, mirëpo është lidhur marrëveshje për servisim e cila është në kundërshtim të plotë me kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit. Prandaj kur kemi parasysh këtë fakt kuptohet qartë se i njëjti grup i OE të rekomanduar për kontratë, janë të papërgjegjshëm sepse nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit.

Gjithashtu marrëveshja është në kundërshtim të plotë me kërkesën e dosjes së tenderit dhe legjislacionin në fuqi, pasi që në marrëveshje specifikohet që Kompania AUTOBUQA SHPK dhe HILI SHPK, do të kryejnë servisimet, kodimet/dekodimet, diagnostifikimet dhe

rigjenerimet, që nënkuptohet se OE i rekomanduar për kontratë me këtë marrëveshje e deklaron si nënkontraktor kompaninë HILI SHPK.

Kur analizohet formulari i tenderit i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë askund nuk figuron kompania HILI SHPK, si nënkontraktor. Shih formularin e mëposhtëm:

Në këtë rast kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë duhej të konsiderohej edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë, duke e treguar qartë favorizimin që po i bëhet të njëjtit OE.

Njëkohësisht tek dosja e tenderit specifikohet sakte: Nënkontraktimet-12.1-a) një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b)Të gjithë

nenkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT. Dokumenti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim të plotë edhe me kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku specifikohet "d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej shërbimet pa kosto shtesë - E diagnostifikimit të prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik.", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej këto shërbime pa kosto shtesë - Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik".

Pra në kërkesë specifikohet se "Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik", dhe jo nga ndonjë palë e tretë, por nga operatori ekonomik, prandaj i njëjti duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit, sepse nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e

plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar "a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 500,000.00€".

Nga dokumentet që i njëjti ka prezantuar në ofertë përkatësisht kur analizohet certifikata e biznesit emri në të figuron AUTOBUQA SH.P.K., ndërsa numri i biznesit 812283430, ndërsa data e regjistrimit të biznesit shënon 22.05.2025.

Kur analizohet kontrata e lidhur me KRU. HIDROREGJIONI JUGOR SH.A PRIZREN, shihet

se data e nënshkrimit të kontratës është 18.02.2020, ndërsa përfundimi i saj është me

dt.14.01.2023, që nënkuptohet se kjo kontratë nuk është kryer nga kjo kompani, pasi që siç e cekëm data e themelimit sipas dokumenteve të biznesit është 22.05.2025.

Të gjitha referencat tjera të cilat janë lëshuar në emër të Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", nuk mund dhe nuk është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues,

pasi që të njëjtat janë të lëshuara për një kompani tjetër dhe jo pikërisht për këtë kompani që është rekomanduar për kontratë. Pasi që siç edhe e cekëm më lartë OE i rekomanduar për kontratë është regjistruar në ARBK me dt.22.05.2025. Njëkohësisht duhet cekur fakti se pronar tek Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" figuron që ka qenë Xhemajl Buqa, ndërsa tani tek AUTOBUQA SH.P.K., janë dy pronar Xhemajl Buqa dhe Liridon Buqaj, andaj në këtë rast kuptohet qartë se AUTOBUQA SH.P.K., është biznes i ri dhe nuk ka lidhje me kompaninë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", pasi janë kompani të ndryshme.

Njëkohësisht në dyshojmë që autorizimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, janë të falsifikuara, pasi që veç nëse analizohen në mënyrë sipërfaqësore, shihet qartë se fonti i shkronjave pothuajse në asnjërin nga autorizimet nuk është i njëjtë. Gjithashtu nga të gjitha autorizimet, diku shënohet tekst në gjuhen shqipe e diku në gjuhen angleze, pra këto janë dyshime se si ka mundësi një autorizim i vetëm të jetë gjysma në gjuhen shqipe, e gjysma tjetër në gjuhën angleze. Prandaj kërkojmë që të komunikohet direkt me kompanitë të cilat i kanë lëshuar autorizimet dhe të konfirmohet se a janë lëshuar në këtë mënyrë këto autorizime për OE të rekomanduar për kontratë.

Duhet cekur fakti se edhe kompania HILI SHPK, për të cilën autoriteti kontraktues dhe OE i

rekomanduar për kontratë e kanë cekur se do të kryej servisimin, sqarojmë se i njëjti nuk ka përvojë në servisimin e këtyre automjeteve siç janë automjetet për të cilat do të bëhet servisimi. Nga dokumentet që janë prezantuar në ofertë shihet qartë se ky servis deri me Faqe 8 nga 11 dt.09.10.2024 nuk ka pasur as servis të tijin, ku me këtë datë ka lidh marrëveshjen për marrjen me qira të objektit. Këtu shihet qartë se i njëjti nuk e posedon edhe përvojën për të kryer punët

e servisimit të automjeteve të cilat janë mjaft komplekse dhe për të njëjtat kërkohet përvojë e madhe në fushën e servisimit, dekodimit, montimit, etj.

Duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

Prandaj kërkohet nga ana e AK-së që të analizohen në tërësi të gjitha pretendimet tona ankimore dhe dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe pastaj të nxjerret një vendim meritor.

Ne me dt.04.02.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, mearsyetime se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e tij është arsyetuar si në vijim:

Arsyetimi i autoritetit kontraktues se ka komunikuar me prodhuesin e pjesëve të cilat i kemi cekur më lartë dhe se i njëjti është zotuar dhe ka aprovuar se do ti përmbush obligimet që i përkasin më autorizimin e lëshuar për këta artikuj dhe i njëjti ka konfirmuar se i prodhon këta artikuj sipas kërkesës së AK-së, është arsyetim krejtësisht jo profesional. Përderisa për pjesët e specifikuar tek pozicioni 176, ne jemi njoftuar nga vet prodhuesi origjinal i këtyre pjesëve Toyota i cili ka deklaruar se prodhuesit të cilat i ka deklaruar grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të autorizuar të bëjnë shitjen apo prodhimin e produkteve të TOYOTA apo pjesëve shtesë, atëherë është jo profesionale të i besohet një prodhuesi i cili nuk është i autorizuar nga prodhuesi origjinal i pjesëve, pasi që vet tenderi ka të bëjë me furnizim me pjesë për automjetet Toyota Land Crusier.

Pra autoriteti kontraktues po e merr parasysh një konfirmim të një prodhuesi i cili nuk është i autorizuar të bëjë shitjen apo prodhimin e pjesëve për automjetet të cilat i prodhon vet prodhuesi ynë pra Toyota, mirëpo nuk po e merr parasysh fare deklaratën e prodhuesit Toyota.

Këtu shihet qartë se AK-ja po e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë, prandaj edhe arsyetimi i të njëjtës është i paqëndrueshëm dhe jo profesional.

Tek pretendimi tjetër i yni ku e kemi cekur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka

prezantuar marrëveshje për marrjen me qira të objektit/servisit, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht është arsyetim favorizues për OE të rekomanduar për kontratë. I njëjti e ka shënuar se mundësi ka qenë që në qoftë se OE nuk ka servis mund të bëjë marrëveshje dhe se është e qartë se ky shërbim do të kryhet nga servisi me të cili ka lidhur marrëveshje OE. Këtu AK-ja po e pranon që servisimin do ta kryej servisi me të cilin ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi OE, ndërsa në marrëveshje specifikohet qartë:

Pa marr parasysh këtë fakt edhe nëse qëndron ajo që AK-ja e ka cekur se servisimin do ta kryej kompania HILI SHPK, atëherë nga ky fakt po kuptohet qartë se OE po mbështetet në kapacitetin e një subjekti tjetër për të përmbushur kërkesat teknike, përkatësisht servisimin. Në këtë rast, sipas ligjit, subjekti mbështetës apo nënkontraktori duhet të deklarohet, përderisa vet AK-ja po e pranon që HILI SHPK do të kryejë shërbimin, pra i njëjti është nënkontraktor.

Pra në këtë rast, marrëveshja është për kryerjen e servisimit atëherë duhej të deklarohet

nënkontraktimi, ndërsa në rast se OE do të bëj servisimin, atëherë është dashur të prezantohet marrëveshja për marrjen me qira të objektit. Në këtë rast asnjëra nga këto dy kushte nuk është përmbushur dhe si e tillë oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme dhe njëkohësisht edhe arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se tek dosja e tenderit specifikohet sakte: Nënkontraktimet- 12.1-a) një deklaratë ku deklarohet nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe

b)Të gjithë nënkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi

përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.

Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, AK-ja pretendimin tonë ankimor e ka cilësuar si të pa bazuar, duke dhënë arsyetimin e njëjtë përsëri, ku e ka cekur se çmimet tona janë shumë më të larta se sa çmimet e tregut. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe tendencioz, sepse ne e kemi sqaruar qartë se çmimet tona janë dhënë nga prodhuesi dhe të njëjtat janë në harmoni me çmimet e tregut, e për më tepër ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin

kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh, pasi që ne po diskriminohemi si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, pasi që e ka refuzuar kërkesën tonë pa ndonjë bazë ligjore.Faqe 10 nga 11

Duhet cekur fakti se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk është distributor i autorizuar i Toyota-s dhe, rrjedhimisht, nuk ka kapacitet objektiv për të

furnizuar disa nga pjesët e kërkuara që janë prodhim ekskluziv i prodhuesit dhe nuk mund të prodhohen nga dikush tjetër pa autorizim. Ndërsa nga analiza e procedurave të njëjta të zhvilluara në tri vitet e fundit, në rastet

kur operatori ekonomik i rekomanduar tani për kontratë kishte dështuar të përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit për shkak të pamundësisë për furnizim të disa pozicioneve të paramasës, në procedurat të cilat janë publikuar pastaj, autoriteti kontraktues kishte larguar pikërisht ato pozicione nga lista e pjesëve të kërkuara. Këto ndryshime nuk kanë qenë të natyrës teknike apo funksionale (p.sh. ndryshim i nevojave reale të AK-së), por të njëjtat janë bërë me qëllimin e vetëm që operatori ekonomik AUTOBUQA SH.P.K. të mund të plotësojë kriteret e dosjes së tenderit.

Nga ato që i sqaruar më lartë, kuptohet qartë se vendimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, e për më tepër ky vendim është tendencioz pasi që po favorizohet OE o rekomanduar për kontratë edhe përkundër faktit që i njëjti është i papërgjegjshëm.

Njëkohësisht po diskriminohemi ne si kompani e përgjegjshme dhe e specializuar për furnizim dhe servisim të pjesëve të kërkuara, e ku jemi kompani e autorizuar nga vet prodhuesi i këtyre pjesëve.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezultojnë se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues

do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojmë në mënyrë transparente", mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në Pretendimin " AUTOTRADE " SH.P.K"- Prishtinë

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje të tenderit për kërkesat 71&7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale e cila kërkohet: c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës) Dëshmia e kërkuar dokumentare: c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj. Dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional b) OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km) Dëshmia e kërkuar dokumentare: b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre.

Eksperti shqyrtues thekson Hartimi i e dosjes te tenderit është kërkesës e nenit 27 te LPP dhe nenit 17 RRPP Ne përputhje me nenin 17 .12 te RRPP së 17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime paratenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë .dhe se Operoret ekonomik kanë pasur mundësi te mjaftueshme për te përgatitur një oferte te mirë sepse Fillimi i procedurës Titulli“FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-se” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1", është me dt 04.11.2025 . sqarimi i tenderëve me dt 27.11.2025 dhe hapja e ofertave Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 04.12.2025 në orën 14:00 QE do te thotë se OE kanë pasur kohe te MJAFTUESHEME TE PERGADITIN NJE OFERTE TE MIRE .

Eksperti shqyrtues thekson se dhe sipas RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjene tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve..... dhe se 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues thekson se Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për sqarime të tenderit është bërë duke respektuar LPP ku theksohet se në rast të dyshimeve nga AK të mos përbushjes së kushteve nga OE. LPP i ka falur të drejtën Autoritetit edhe sipas Dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës..

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomikë për të plotësuar apo të qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Ku Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës....dhe se UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve .AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së , dhe me letër sqaruese Ka kërkuar sqarim të dy Operatorëve ekonomikë

Eksperti shqyrtues mendon se pas analizimit të pretendimeve të OE "AUTOTRADE" SH.P.K dhe dokumentacionit të administruar në dosje, vlerëson se çështja e çmimeve nuk mund të trajtohet e ndarë nga natyra e produktit të ofertuar dhe nga autorizimi i prodhuesit.

OE ankues ka argumentuar se çmimet e ofruara janë çmime të tregut për pjesë origjinale Toyota, të mbështetura me dëshmi nga sistemi i prodhuesit dhe me zbritje specifike për Policinë e Kosovës. Në këtë kontekst, vlerësimi i "çmimit të lartë" nga ana e AK-së do të ishte i drejtë vetëm nëse krahasimi është bërë mbi produkte të së njëjtës natyre – pra pjesë origjinale të autorizuara nga prodhuesi.

Nga ana tjetër kërkesë nga AK Sqarim shtesë : te dt 26.12.2025 OE AUTOBUQA SH.P.K, në letrën sqaruese të datës 29.12.2025, ka deklaruar se produktet e tij "krahasohen 90% të njëjta sikur origjinali (si direkt prodhuesi)", duke pranuar në mënyrë të tërthortë se pjesët e ofertuar nuk janë pjesë origjinale të prodhuesit. Kjo deklaratë ka relevancë të drejtpërdrejtë juridike, sepse konfirmon se çmimi i ofertuar prej tij i referohet produkteve alternative (aftermarket), dhe jo produkteve origjinale të autorizuara nga prodhuesi Toyota , dhe po citoi atë çka është shkruar TE DHEN NE SQARIM TE TENDERVE DT 29.12.2025

" P.sh: Në tregun tonë mund të hasni edhe produkte pa firmë vetëm paketim, që nuk dihet origjina e as ku prodhohet.

Produktet tona krahasohen 90 % të njëjta sikur origjinali (si direkt Prodhuuesi) ."

Eksperti Shqyrtues thekson se Në këtë pikë, ndërlidhet drejtpërdrejt edhe kërkesa e Dosjes së Tenderit për "Autorizim të lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezervë ose distributori i autorizuar". Për shembull nëse për pozicionin nr. 176 (moduli i airbagut – pjesë kritike me softuer të mbrojtur) kërkohet autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, atëherë pranimi i një autorizimi nga subjekt që nuk ka licencim nga prodhuesi origjinal për prodhimin e atij komponenti bie ndesh me kërkesën formale të dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues mendon se Rrjedhimisht nuk mund të bëhet krahasim i drejtë i çmimeve ndërmjet pjesëve origjinale dhe pjesëve jo-origjinale. Nuk mund të konsiderohet çmimi "më i ulët i tregut" një

çmim që i referohet një produkti me standard teknik dhe juridik tjetër.

Nëse OE i rekomanduar vet deklaron se produktet janë 90% të njëjta me origjinalin, atëherë ai pranon se nuk janë produkte origjinale të autorizuara nga prodhuesi.

Në këtë kuptim, eliminimi i OE ankues për çmime të pretenduara si “më të larta se tregu”, pa një analizë krahasuese të produkteve të së njëjtës natyrë (origjinale me origjinale), dhe njëkohësisht pranimi i ofertës së OE tjetër që vet deklaron se produktet nuk janë origjinale, krijon trajtim jo të barabartë dhe bie ndesh me nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik lidhur me vlerësimin strikt sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Prandaj, nga analiza e bërë, pretendimi i OE ankues lidhur me çështjen e çmimit në raport me autorizimin e prodhuesit dhe natyrën e pjesëve të ofertuar, rezulton i bazuar.

Eksperti Shqyrtues Thekson se pretendim i ““ AUTOTRADE " SH.P.K”- Prishtinë i BAZUAR

Pretendimi i ““ AUTOTRADE " SH.P.K”- Prishtinë

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje të tenderit për kërkesat 91&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionalee cila kërkohet b) OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km) dëshmi

b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre.

d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej shërbimet pa kosto shtesë -E diagnostifikimit të prishjeve -Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik. Deshmi d) OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim se do t'i kryej këto shërbime pa kosto shtesë - Diagnostifikimi i prishjeve - Kodimi dekodimi i pjesëve- sistemeve - Regjenerimi i automjeteve - Si dhe çdo problem tjetër i natyrës elektronike që kërkohet nga AK, duhet të kryhet nga Operatori Ekonomik

Eksperti Shqyrtues do te ndalet ne pretendimin ankimor përcaktues, sipas kërkesës së parashtruar në DT OE është i obliguar ti kryej shërbimet sipas kërkesës së AK. Këto shërbime duhet të kryhen brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 km nga Flota Operative. OE i jepet mundësia që të lidhë kontratë me ndonjë servis i cili gjendet brenda rrezes (15km) ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar b) OE duhet të sjellë Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre.

Eksperti shqyrtues vëren se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar marrëveshjen të lidhur me kompaninë Autoservis HILI, mirëpo kur analizohet marrëveshja e duke u nisur nga titulli i kësaj Marrëveshje marrëveshje për servisimin e automjeteve për këtë projekt, shihet qartë se e njëjta nuk është për marrje me qira të objektit, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Pra tek dëshmia dokumentare është specifikuar decidivisht “ Nëse OE objektin e servisit e ka me marr me qira, duhet të dëshmohet me marrëveshje në mes tyre”, me këtë rast OE i rekomanduar për kontratë ka

ofertuar me një marrëveshje e cila është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që në këtë marrëveshje specifikohet që Kompania AUTOBUQA SHPK dhe HILI SHPK, do të kryejnë servisimet, kodimet/dekodimet, diagnostifikimet dhe rigjenerimet, që nënkuptohet se grupi i OE të rekomanduar për kontratë me këtë marrëveshje e deklarojnë si nënkontraktor kompaninë HILI SHPK, e pasi që verifikohet formulari i tenderit të dorëzuar nga ky OE i rekomanduar kompania HILI SHPK nuk evidentohet se është paraqitur si nënkontraktor

Si përfundim, OE i rekomanduar për kontratë është dashur të ketë përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qartë kërkesën e AK-së, konkretisht:: Deklaratë mbi Lokacionin e servisit (adresa), Lokacionin e Flotës Operative,

Dhe, nëse objekti i servisit merret me qira, marrëveshje e vlefshme në mes palëve që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit të atij objekti.

Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë (kur objekti nuk është në pronësi të OE-së), ose nëse marrëveshja nuk e dëshmon qartë marrjen me qira të objektit brenda rrezes së kërkuar 15 km, atëherë OE nuk e ka përmbushur kërkesën thelbësore të Dosjes së Tenderit.

Prandaj, OE i rekomanduar është dashur të ketë dëshmuar në mënyrë të qartë dhe të plotë bazën juridike për shfrytëzimin e lokacionit të servisit brenda territorit të përcaktuar nga AK. Në të kundërtën, oferta e tij do të duhej të konsiderohej jo e përgjegjshme për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Eksperti Shqyrtues Thekson se pretendim i OE " AUTOTRADE " SH.P.K"- Prishtinë gjendet i BAZUAR

Pretendimi i " AUTOTRADE " SH.P.K"- Prishtinë

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar "a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 500,000.00€".

Nga dokumentet që i njëjti ka prezantuar në ofertë përkatësisht kur analizohet certifikata e biznesit emri në të figuron AUTOBUQA SH.P.K., ndërsa numri i biznesit 812283430, ndërsa data e regjistrimit të biznesit shënon 22.05.2025.

Kur analizohet kontrata e lidhur me KRU. HIDROREGJIONI JUGOR SH.A PRIZREN, shihet

se data e nënshkrimit të kontratës është 18.02.2020, ndërsa përfundimi i saj është me

dt.14.01.2023, që nënkuptohet se kjo kontratë nuk është kryer nga kjo kompani, pasi që siç e cekëm data e themelimit sipas dokumenteve të biznesit është 22.05.2025.

Të gjitha referencat tjera të cilat janë lëshuar në emër të Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", nuk mund dhe nuk është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues,

pasi që të njëjtat janë të lëshuara për një kompani tjetër dhe jo pikërisht për këtë kompani që është rekomanduar për kontratë. Pasi që siç edhe e cekëm më lartë OE i rekomanduar për kontratë është regjistruar në ARBK me dt.22.05.2025. Njëkohësisht duhet cekur fakti se pronar tek Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" figuron që ka qenë Xhemajl Buqa, ndërsa tani tek AUTOBUQA SH.P.K., janë dy pronar Xhemajl Buqa dhe Liridon Buqaj, andaj në këtë rast kuptohet qartë se AUTOBUQA SH.P.K., është biznes i ri dhe nuk ka lidhje me kompaninë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", pasi janë kompani të ndryshme.

Përgjigje Pretendimi " " AUTOTRADE " SH.P.K"- Prishtinë 3

Eksperti shqyrtues lidhur me kapacitetin teknik/profesional dhe referencat Pas shqyrtimit të pretendimit të OE ankues, sipas të cilit OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit ku është kërkuar që: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) në vlerë minimale 500,000.00 €",

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar për arsye procedurale, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezultojnë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës për rishqyrtim të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues, por është paraqitur për herë të parë drejtpërdrejt në ankesën e ushtruar në OSHP.

Në përputhje me nenin 64.2 të Rregullores nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, ankesa në OSHP nuk mund të përmbajë pretendime të reja që nuk janë ngritur më parë në fazën e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Qëllimi i kësaj dispozite është që t'i jepet mundësia AK-së të trajtojë fillimisht çdo pretendim në nivel administrativ, përpara se çështja të kalojë në shqyrtim pranë OSHP-së.

Në rastin konkret, OE ankues nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim lidhur me çështjen e referencave dhe kapacitetit teknik/profesional të OE të rekomanduar, por e ka ngritur këtë pretendim drejtpërdrejt në fazën e ankesës. Për rrjedhojë, kemi të bëjmë me pretendim të ri proceduralisht të palejuar.

Në këto rrethana, pa hyrë në vlerësimin material të dokumenteve të referuara (certifikata e biznesit, data e regjistrimit, referencat e subjektit paraprak etj.), Eksperti shqyrtues Thekson se pretendimi është i papranueshëm për shqyrtim në këtë fazë, për shkak të mosrespektimit të procedurës së detyrueshme të rishqyrtimit pranë AK-së.

Rrjedhimisht, pretendimi i OE ankues në këtë pikë gjendet i pabazuar për arsye procedurale.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " AUTOTRADE " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së" me numër të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – " AUTOTRADE " SH.P.K.



Driton Fetaj